

ËSHTË KOHA PËR TË KUJTUAR - THUAJ **JO** KRIMEVE NË RRUGË



DEKLARATË E PËRBASHKËT

E diele, 15 Nëntor 2015, Prishtinë

Nisur nga aksidentet tragjike të ditëve të fundit, ku si pasojë e tyre humbën jetën disa qytetarë të Republikës, mendojmë se është koha e fundit për veprim të përbashkët dhe të menjëhershëm për të ju thënë stop krimeve në rrugë.

112 JETËRA TË HUMBURA

(01 JANAR—15 NËNTOR 2015)

E diela e tretë e muajit Nëntor shënon Ditën Botërore të përkujtimit të miliona njerëzve që humbin jetën në trafikun rrugor dhe njëkohësisht për të ju dhënë mbështetje familjarëve të viktimave.

Në Kosovë këtë ditë përkujtimore po e shënojmë për të kujtuar 112 jetërat e humbura. Përveç përkujtimit ky marsh është edhe protestues dhe thërret për vetëdijesimin e të gjithë pjesëmarrësve në rrugë për sjellje të kulturuar dhe të përgjegjshme në trafik. Në të njëjtën kohë thërret organet kompetente që të rrisin efektivitetin dhe përgjegjësinë në punën e tyre në mënyrë që të rritet siguria në rrugë.

Edhe sa qytetarë duhet vdesin që kjo çështje të trajtohet si urgjente dhe me prioritet?! Asgjë nuk do të duhej të jetë më e rëndësishme për shtetin dhe shoqërinë se sa jeta e qytetarëve të vet.

Në a kemi obligim qytetar moral të ngremë zërin për këtë situatë të rëndë në rrugët e vendit, ku përditë vdesin dhe lëndohen qytetarët tanë, pa llogaritur dëmet e mëdha materiale të shkaktuara si pasojë e aksidenteve në rrugë.

Fajtori për sigurinë në rrugë dihet, dhe nuk është jetim sikurse në rastet tjera, fajtorë jemi të gjithë ne, pjesëmarrësit në rrugë, ngasës apo këmbësor, të cilët me veprimet e tyre të papërgjegjshme rrezikojnë sigurinë në rrugë.

Të gjithë së bashku mund të bëjmë më shumë për të penguar të keqen dhe për të ofruar më shumë siguri në rrugë.

Organizatorët

ËSHTË KOHA E FUNDIT PËR VEPRIM TË MENJËHERSHËM!

STOP KRIMEVE NË RRUGË